



UNIVERSITETI I EVROPES JUGLINDORE

УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА

ЕВРОПА SOUTH EAST EUROPEAN

UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE BASHKOHORE

ФАКУЛТЕТ ЗА СОВРЕМЕНИ ОПШТЕСТВЕНИ НАУКИ

FACULTIES OF CONTEMPORARY SOCIAL SCIENCES

STUDIMET POSDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

**NDIKIMI I PANDEMISË COVID – 19 NË
DIPLOMACINË KOSOVARE**

KANDIDATI:
ANDUENA BEQIRI

MENTORI:
Prof.Dr. AGRON RUSTEMI

SHKUP, QERSHOR 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

1.ABSTRAKTI.....	4
1.1.ABTRACT.....	5
1.2.АБСТРАКТ.....	6
2.HYRJE.....	7
2.1.Lënda e hulumtimit.....	8
2.2. Qëllimet e hulumtimit.....	9
2.3.Hipoteza.....	9
2.4. Metodologjia e hulumtimit.....	10
2.5 Rëndësia e punimit.....	10
KAPITULLI I.....	11
3. Kosova në kapitull të ri historik.....	11
3.1 Burimet dhe ndikimi i pandemisë globale.....	13
3.2 Mjedisi i punës në kushte Pandemie në Kosovë.....	15
3.3 Çfarë është Diplomacia Shëndetësore.....	21
KAPITULLI II.....	25
4. Pandemia COVID – 19 dhe Diplomacia Kosovare.....	25
4.1 Ndikimi i pandemisë në diplomaci.....	28
4.2 Diplomacia shëndetësore në pandemitë e kaluara.....	31
4.3 Mungesë të informacionit rreth COVID – 19.....	34
KAPITULLI III.....	40
5. E ardhmja e diplomacisë multilaterale pas pandemisë COVID 19.....	40
5.1 Ndryshimet me pandemi COVID – 19 në diplomacinë Kosovare.....	45
5.2 Ballafaqimi, ndikimi politik, ekonomik dhe sundimi i ligjit gjatë Pandemisë COVID – 19.....	49
5.2.1 Ndikimi Politik.....	54
5.2.2 Ndikimi ekonomik.....	56
5.2.3 Sundimi i ligjit gjatë Pandemisë COVID – 19.....	63
6. PËRFUNDIMI.....	68
7. BIBLIOGRAFIA.....	71

Një efekt i mundshëm i pandemisë COVID-19, do të jetë një fokus në rritje e diplomacisë shëndetësore, një temë që rrallë është marrë nga studiuesit të marrëdhënieve ndërkombëtare. Pas shqyrtimit të literaturës ekzistuese mbi diplomacinë shëndetësore, argumentoj për dobinë e duke dalluar synimet e shteteve, nga praktikat e tyre të diplomacisë shëndetësore në avancimin tonë, të kuptuarit se kur shtetet angazhohen në diplomacinë shëndetësore, diplomacinë bilaterale, rajonale ose shtrirje globale.

Historia e fundit e shpërthimeve, të sëmundjeve infektive të shekullit të XXI, suxheron një largim të mundshëm, nga diplomacia shëndetësore me pjesëmarrje globale.

COVID-19, jep shembuj të shumtë, nga kritikë e përhapura ndaj Shëndetësisë Botërore.

Megjithatë pandemitë, bëhen më të shpeshta, diplomacia shëndetësore kosovare, është më e lokalizuar dhe ka të ngjarë të jetë më pak efektive, duke pasur parasysh domosdoshmërinë e zbutjes dhe kontrollit global. Historikisht, diplomacia kosovare, ka mbetur në periferi të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Pandemia COVID – 19, ka dhënë shembuj të shumë shteteve, që përqendrojnë shëndetin në politikën e jashtme, një praktikë që ka të ngjarë dhe do të vazhdojë edhe pas pandemisë. Është koha, për të çuar përpara diplomacinë, në studimin dhe praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Gjatë kësaj kohe mund të themi se Kosova, kishte një etapë të rëndësishme në diplomaci, me njohjen nga Izraeli. Marrëveshja e Uashingtonit, në kohë pandemie, ishte një e arritur shumë e madhe për ne, për të forcuar bashkëpunimin në mes të Izraelit dhe Kosovës.

Jo e gjithë diplomacia kosovare, ka të bëjë vetëm me shëndetin.

Diplomacia kosovare dhe politikat ndërkombëtare, bashkëpunojnë dhe synojnë të kenë zhvillime të rëndësishme midis shteteve të tjera. Shtetet zgjedhin midis një game të gjerë opsionesh, për formatimin e diplomacisë së tyre shëndetësore, nga angazhimi me organizata ndërqeveritare globale.

Por edhe pandemitë, krijojnë mundësi për shtetet, që të ndjekin qëllimet e politikës së jashtme, që u shërbejnë kryesisht interesin kombëtar. Synimi kryesor, i shteteve në pandemi, është mbrojtja fizike, ekonomike dhe shëndeti i qytetarëve.

Fjalët kyçe: Pandemia Covid-19, Organizatën Botërore Shëndetësore (OBSh), Inteligjenca artificiale (AI), Qeveria, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

1.1. ABSTRACT

A possible effect of the COVID-19 pandemic, will be a growing focus of health diplomacy, a topic that is rarely taken up by scholars of international relations. After reviewing the existing literature on health diplomacy, I argue for the usefulness of distinguishing the intentions of states, understanding when states engage in health diplomacy with a bilateral, regional or global reach.

Recent history of infectious disease outbreaks in of the XXI century, suggests a departure possible from health diplomacy with global participation.

COVID-19, provides numerous examples, from widespread criticism of World Health.

However pandemics are becoming more frequent, Kosovar health diplomacy, is more localized and is likely to be less effective, given the need for global mitigation and control.

Historically, Kosovar diplomacy has remained on the periphery of international relations.

The COVID-19, pandemic has provided numerous examples of health-focused states, in foreign policy, a practice that is likely and will continue even after the pandemic.

It is time to move diplomacy forward in the study and the practice of international relations.

During this time we can say that Kosovo had an important stage in diplomacy, with recognition by Israel. The Washington agreement, in pandemic times was a very accomplished many of us, to strengthen the cooperation between Israel and Kosovo.

Not all Kosovar diplomacy is about health. Kosovar diplomacy and international policies cooperate and aim to have important developments among other states. States choose between a wide range of options for formatting their health diplomacy, from engaging with global intergovernmental organizations.

But pandemics also create opportunities for states, to pursue foreign policy goals that the national interest grew. The main target of states in the pandemic is their physical, economic protection and health.

Keywords: Covid-19 Pandemic, World Health Organization (WHO), Artificial Intelligence (AI), Government, European Convention on Human Rights.

1.2. АБСТРАКТ

Можен ефект од пандемијата COVID-19, ќе биде се поголем фокус на здравствената дипломатија, тема која ретко се занимава од научниците за меѓународни односи.

По разгледувањето на постоечката литература за здравствената дипломатија, Јас се расправам за корисноста да се разликуваат намерите на државите од нивните практики на здравствена дипломатија, разбирање кога државите се вклучуваат во здравствена дипломатија со билатерален, регионален или глобален досег.

Последната историја на појава на заразни болести во XXI век, сугерира можно отстапување од партиципативната здравствена дипломатија.

COVID-19 дава бројни примери, од широката критика на Светското здравство.

Сепак, пандемиите стануваат се почести, косовската здравствена дипломатија, е повеќе локализиран и веројатно е помалку ефикасен, со оглед на потребата за глобално ублажување и контрола. Историски гледано, косовската дипломатија остана на периферијата на меѓународните односи.

Пандемијата COVID-19 даде бројни примери на земји кои го фокусираат здравјето на надворешната политика, практика која е веројатна и ќе продолжи и по пандемијата.

Време е да се унапреди дипломатијата во проучувањето и практикувањето на меѓународните односи. За тоа време можеме да кажеме дека Косово имаше важна фаза во дипломатијата, со признавање од Израел.

Договорот од Вашингтон, во време на пандемија беше многу големо достигнување за нас, за зајакнување на соработката меѓу Израел и Косово.

Не целата косовска дипломатија е поврзана со здравјето. Косовската дипломатија и меѓународната политика, соработуваат и имаат за цел да имаат значителен развој меѓу другите држави.

Државите избираат од широк спектар на опции за форматирање на нивната здравствена дипломатија, од ангажирањето со глобалните меѓувладини организации.

Но, пандемијата, исто така, создава можности за државите да ги следат целите на надворешната политика во служба на националниот интерес пред се. Главната цел на пандемиските состојби е физичката, економската заштита и здравјето на граѓаните.

Клучни зборови: Пандемија на Ковид-19, Светска здравствена организација (СЗО), Вештачка интелигенција (АИ), Влада, Европска конвенција за човекови права.

2.HYRJJE

Në shekullin XXI, filloj një ritëm i rritur i pandemisë, duke vendosur zgjedhjen e shteteve në zbatimin e diplomacisë shëndetësore në lehtësimin të mprehtë.

Natyra e pandemisë, kërkon bashkëpunim ndërkombëtar, për zbutjen dhe kontrrollin.

Por edhe pandemitë, krijojnë mundësi për shtetet, që të ndjekin qëllimet e politikës së jashtme, që u shërbejnë kryesisht interesin kombëtar në vend.

Synimi kryesor dhe jo vetëm i Kosovës, në pandemi është mbrojtja fizike, ekonomike dhe shëndeti i qytetarëve.

Ndonjëherë, ky synim arrihet më së miri duke punuar me Organizatën Botërore Shëndetësore, për çështje shëndetësore.

Në këtë studim, Kosova gjithashtu mundohen të përdorë diplomacinë shëndetësore, për të ndërtuar vullnetin e mirë dhe duke ndjekur synimet dhe raportet e Organizatës Botërore Shëndetësore.

Duke pasur parasysh gjatë pandemisë Covid - 19, shtetet vlerësojnë urgjencën, e qëllimeve të tyre të ndryshme dhe mjetet më të mira për t'i arritur ato nëpërmjet diplomacisë.

Në këtë punim hidhet dritë në të ardhmën e diplomacisë kosovare, ndaj pandemisë dhe efektin e aftësisë së këtyre institucioneve, për të trajtuar në mënyrën efektive pandemitë e ardhme.

Gama e çështjeve me të cilat përballlet Diplomacia Kosovare është më e kufizuar, megjithatë ato nuk janë më pak urgjente apo intensive se ato të shteteve të mëdha.

2.1.Lënda e Hulumtimit

Kjo është një çështje, që shihet shpesh në hulumtimet dhe raportet të shumta, nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimi Europian (BE), dhe organizatat e tjera ndërkombëtare shkencore . Sot kur bota po përballlet me Pandemin COVID-19, në përgjithësi efektet në politikën e jashtme, do të vazhdojnë të jenë të shumta. Pandemia COVID-19 ka pasur impakt serioz, në relacionet dhe komunikimet në mes të shteteve, duke ndaluar komunikimet fytyrë me fytyrë (B2B), duke ju përshtatur platformave virtuale.

Koncepti i Diplomacisë dhe politikave të jashtme ka të bëjë me takimet midis njerëve, tash e qindar vite, aktivitetet zhvillohen me komunikime, në mes të dy apo më shumë personave, të cilët kanë përfaqësim diplomatik të një shteti. Bashkërendimi i dijeve dhe eksperiencave të ndryshme është një nga zgjedhjet më të mëdha të Pandemisë në botë.

Pothuajse çdo vend dhe territor raporton raste të koronavirusit, sëmundja infektive e lidhur me një lloj të ri të koronavirusit, ku po merr shumë jeta dhe po i bllokun vendet. COVID – 19, e ka gjuhëzuar të gjithë botën, andaj bota duhet të përshtatet shpejt, me mënyrat e reja të jetesës dhe mënyrat e reja të punës. Ndikimi në Diplomacisë kosovare është veçanërisht i prekur nga zhvillimet e fundit, pasi takimet, konferencat, ngjarjet e mëdha po anulohen. Andaj Pandemi, po teston botën tonë të globalizuar.

Si kurrë më parë në politikën e jashtme, diplomacia dhe diplomatët janë në kërkim të formave të reja dixhitale, duke vazhduar komunikimin, e marrëdhënieve me shtetet dhe institucionet multilaterale edhe në kohë krize.

Kjo është dëshmi e një ndryshimi të madhë, të cilin e ka imponuar pandemia në diplomaci dhe në politikat e jashtme, disa nga këto ndryshime pa dyshim do të mbesin edhe pasi të kalojë COVID-19.

2.2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij punimi, është hulumtimi më i thellë dhe i detajuar rreth Pandemisë Covid -19, duke përfshirë gjithë botën për një kohë shumë të shkurtër e posaqërisht Kosovën.

Hulumtimin do të pasurojmë, me deklarata të ndryshme zyrtare, intervista me ekspertë të politikës dhe diplomacisë ndërkombëtare.

Ky punim si njëri nga punimet e pakta të kësaj fushe, e ka për qëllim që të vendosë dhe përcaktoj kriteret e nevojshme dhe domosdoshme për zhvillimet e mëtutjeshme duke pasur në konsideratë, diferencat që ekzistojnë midis vendeve të zhvilluara dhe ato në zhvillim. Ky studim do të tentojë, një analizë të përceptimit që bota, po përballlet me një pandemic, për të cilën as nuk janë në dijeni nga dhe se si erdhi në mesin tonë.

Nga gjithë punimi dhe çështjet e kërkimit të evidentuara dhe të shtjelluara tek paraqitja e rezultateve dhe diskutimi i tyre, orientohen dhe burojnë disa hipoteza. Diplomacia dhe simboli i saj, më i dukshëm i misionit diplomatic, është e hapur për ndryshime të konsiderueshme dhe bëhet perms, një sistemi të kombinuar formal dhe joformal në përputhje me standardet e vendosura.

2.3. Hipoteza

Në këtë propozim për tezën e masterit, pretendoj të diskutojmë këto hipoteza kryesore:

1. Pandemia Covid 19, kishte ndikim të madhë në Diplomacinë Kosovare.
2. Efektet e pandemisë në politikat e jashtme, duke pasur impakt serioz në relacionet dhe komunikimin në mes të shteteve.
3. Përhapja e shpejtë e Pandemisë, ndryshojë shumë nga rregullat e Protokolit Diplomatik, në Republikën e Kosovës.
4. Mbyllja e kufijeve dhe kufizimi i lëvizjes, së njerëzve në mbarë botën, ka bërë që të gjitha vizitat zyrtare, të anulohen dhe takimet diplomatike, të kalojnë në platformën virtuale.
5. Roli i Organizatës Botërore Shëndetësore – OBSH-ja, karshi Kosovës.
6. Koronavirusi ka marrë vëmendje të madhe, në nivelin global, ku ka të bëjë edhe në aspektin diplomatikë.

Përfundimet e studimeve dhe analizave empirike, do të tregojnë rezultatin përfundimtar të hipotezave të paraqitura.

2.4. Metodologjia e Hulumtimit

Gjatë këtij hulumtimi, do të përdorim të dhëna nga burime parësore dhe dytësore që do të thotë artikuj të ndryshëm, deklarata, intervista, etj.

Në shërbim të hulumtimit do të ndjekë këto metoda:

1. Metoda e analizës dhe sintezës-kjo metodë do të përdoret për prezentim logjik të objektit të hulumtimit.
2. Metoda e induksionit dhe deduksionit - kjo metodë do përdoret për të ardhur deri te konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me tezën në fjalë.
3. Metoda e intervistimit - kjo metodë do të përdoret për të marrë opinion e eksperteve të ndryshëm për çështje të rëndësishme historike.

2.5. Rëndësia e punimit

Rëndësia e tezës në fjalë, është grumbullimi dhe elaborimi i fakteve të shumta, në një studim të veçantë duke përfshirë këtu periudhën kohore Pandemike prej dy viteve në Kosovë.

Janë bërë studime, rreth pandemisë në politikat e jashtme dhe të brendshme, në faza të caktuara, por konsideroj që duhet një studim më i thellë në aspektin politik dhe ndikimi i politikës ndërkombëtare, veçanërisht asaj për Mbrojtjen Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut.

Kapitulli I

2. Kosova në kapitull të ri historik

Kohezioni, shpesh ndihmon në krijimin, e qëllimit dhe konsistencës së përbashkët në politikën e jashtme dhe diplomacinë e shteteve të vogla. Mund të zvogëlojë komplikimet në qeverisje, që rrjedhin nga interesat dhe perspektivat konkurruese ose konfliktuale të një shoqërie komplekse dhe të larmishme. Megjithatë, kufizimet e burimeve nënkuptojnë, se shtetet e vogla shpesh kanë më pak burime të nevojshme për ndërveprim efektiv me shtetet e tjera. Burimet e nevojshme për të mbledhur dhe analizuar informacionin përkatës, për të përpunuar dhe hartuar pozicione dhe perspektiva, si dhe për të mbledhur dhe vendosur rreshtime dhe rrethana në mbështetje të pozicioneve të tyre mund të jenë të pamjaftueshme.¹

Ngjarja e vetme, në kohën e COVID-19, mund të themi historike, ka qenë ajo nga njohja e Izraelit, në Washington me 4 shtator 2020.²



¹ Evropa e Lire, (03 shtator, 2021), Marrëveshja e Washingtonit, Gjetur në:

<https://www.evropaelire.org/a/marreveshja-uashingtonit-nje-vit-pas/31442223.html>

² Klan Kosova, (04 Shtator 2021) Një vit nga marrëveshja e 4 shtatorit në Washington, Gjetur në:

<https://klankosova.tv/nje-vit-nga-marreveshja-e-4-shtatorit-ne-washington-video/>

Diplomacia kosovare në kohën e pandemisë, arriti një marrëveshje historike, gjithmonë duke pasur ndërmjetësim nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga ish-presidenti Donald Trump është bërë njohja e Kosovës nga Izraeli. Në marrëveshje, kërkohet që Kosova duhet të hap Ambasadën në Jerusalem.³

- **Në dokumentin nënshkruar nga kryediplomatët e Kosova dhe Izraeli thuhet:**

“Të udhëhequr nga vullneti i përbashkët, duke promovuar dhe forcuar lidhjet miqësore, si dhe për të zgjeruar bashkëpunimin mes dy vendeve dhe bazuar në parimet universale të ligjit ndërkombëtar, duke riafirmuar përkushtimin e përbashkët për të forcuar bashkëpunimin e frytshëm në sferën politike, ekonomike, të tregëtisë, teknike e kulturore dhe në sfera të tjera të interesit të përbashkët, (Kosova dhe Izraeli), kanë vendosur që të themelojnë marrëdhënie diplomatike në nivel ambasadorësh”.

Ministria e Jashtme e Kosovës, të asaj kohe Meliza Haradinaj- Stublla dhe Ministri i Jashtëm i Izraelit, Gabriel Ashkenzi, festuan marrëveshjen me një ceremoni virtuale, ku të dy liderët nënshkruan dokumentet e tyre.

Gjatë ceremonisë së nënshkrimit, të marrëveshjes të mbajtur përmes Video-Konferencës Zoom, Ministri i Jashtëm i Izraelit, Gabriel Ashkenzai, theksoj se lidhjet e reja janë historike duke pasqyruar një ndryshim, në rajon dhe në marrëdhëniet e botës arabe – muslimane me Izraelin. Në ceremonin virtuale, gjatë nënshkrimit të ceremonisë, morën pjesë Nënkretari amerikan i shtetit, Z. Palmer dhe Ambasadori Amerikan, në Prishtinë dhe Jerusalem.

Ministri Ashkenazi, marrëdhënien diplomatike në mes Izraelit dhe Kosovën e quan “Histori”.

Ndërsa Ministria Haradinaj-Stublla, potencojë se marrëveshje në mes Izraelit dhe Kosovës shënojë një kapitull historik.⁴ Pas një kohe të gjatë, rreth gjashtë muaj pas njohjes së Kosovës nga Izraeli, u hap Ambada me një ceremoni të shkurtër, duke e ngritur flamurin e Kosovës, para ndërtesës në Jerusalem. Njohja e Izraelit është shumë e rëndësishme për Kosovën, duke ndihmuar integrimin e saj në organizata ndërkombëtare.⁵

³ The voice of the America, (02 mars 2021) , Izraeli dhe Kosova vendosin marrëdhëniet diplomatike, Gjetur në: <https://editorials.voa.gov/a/5798753.html>

⁴ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (02 shkurt 2021),Kosova dhe Izraeli vendosin marrëdhënie diplomatike mes dy shteteve, Gjetur në: https://www.mfa-ks.net/single_lajmi/4292

⁵ Izraeli sot, (04 gusht 2020),Kosova pershendet merrveshjen Izrael – EBA, Gjetur në: <https://www.izraelisot.com/2020/08/14/kosova-pershendet-marreveshjen-izrael-eba-meliza-haradinaj-deshmi-per-paqe-dhe-zhvillim/>

3.1. Burimet dhe ndikimi i pandemisë globale

Përhapja e shpejtë e koronavirusit po teston botën, diplomacia është veçanërisht më e prekur nga këto zhvillime, pasi takimet, konferencat dhe ngjarjet e tjera të mëdha anulohen. COVID-19, u shfaq në Wuhan, Kinë në fund të vitit 2019 dhe u përhapë shpejt, sëmundja infektive e lidhur me një lloj të ri të koronavirusit, po merr jetë dhe po i ndalon vendet. Gjithë bota po e kupton, se duhet të përshtatemi shpejt me mënyrën e re të jetesës dhe mënyrat e reja të punës. Shtet të tëra janë mbyllur, vizitat shtetërore janë anuluar, udhëtimet zyrtare dhe komunikimet fizike janë kufizuar. Si kurr më parë politika e jashtme, diplomacia dhe diplomatët janë në kërkim të formave të reja dixhitale, për të vazhduar mirëmbajtjen e marrëdhënieve me shtetet dhe me institucionet multilaterale edhe në kohë krize. Pandemia koronavirus ka paraqitur sfida të jashtëzakonshme për diplomacinë, Kosovare, disa praktika janë dashur të përshtaten, ndërsa diplomatët duhet të adresojnë, situatën e menjëhershme të krizës dhe të punojnë drejt përgjigjeve të koordinuara.⁶ COVID-19, nuk është vetëm një pandemi globale dhe krizë e shëndetit publik, duke ndikuar rëndë edhe ekonominë globale dhe tregjet financiare në botë. Reduktimet e ndjeshme të të ardhurave, një rritje e papunësisë dhe ndërprerjet në industrinë e transportit, të shërbimeve dhe të prodhimit janë ndër pasojat e masave për zbutjen e sëmundjeve që janë zbatuar në shumë vende. Është bërë e qartë se shumica e qeverive ka nënvlerësuar rreziqet e përhapjes së shpejtë të COVID-19 dhe ishin kryesisht reaguese në përgjigjen e tyre ndaj krizës. Meqenëse shpërthimi i pandemisë, në të ardhmen e afërt, kërkohen veprime ndërkombëtare proaktive jo vetëm për të shpëtuar jetë, por edhe për të mbrojtur prosperitetin ekonomik. Infeksioni jo vetëm që është kthyer në një krizë të shëndetit publik, por ka prekur edhe ekonominë globale.⁷ Një ndikim i rëndësishëm ekonomik ka ndodhur tashmë në të gjithë globin për shkak të reduktimit të produktivitetit, humbjes së jetëve, mbylljes së bizneseve, ndërprerjes së tregtisë dhe shkatërrimit të industrisë së turizmit. COVID-19 mund të jetë një thirrje, për liderët globalë që të intensifikojnë bashkëpunimin

⁶ Helvetas, (Mars 2021), Ndikimi i Covid-19, Gjetur në:

http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2021/03/Raporti-Covid-19_ALB_02.pdf

⁷ Wikipedia (2020), coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në : https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

për gatishmërinë ndaj epidemisë që të ofrojnë financimin e nevojshëm për veprimin kolektiv ndërkombëtar. Ka pasur informacion të mjaftueshëm mbi kostot e pritshme ekonomike dhe shëndetësore të shpërthimeve të sëmundjeve infektive , por bota ka dështuar të investojë siç duhet në masat parandaluese dhe të gatishmërisë për të zbutur rreziqet e epidemive të mëdha. Qëllimi kryesor i shteteve, në një pandemi është mbrojtja e shëndetit fizik dhe ekonomik të qytetarëve të tyre. Nganjëherë, ky qëllim arrihet më së miri duke punuar për çështje shëndetësore. Diplomacia shëndetësore, e praktikuar në këtë mënyrë mund të shfrytëzojë kostot e reduktuara të transaksioneve dhe të shohë rritjen e shkëmbimit të informacionit. Si është zhvilluar diplomacia shëndetësore, gjatë COVID-19 dhe krizave të kaluara globale të shëndetit, marrëdhëniet ndërkombëtare, kanë studiuar shëndetin global, për një kohë të gjatë.⁸ Përveç mësimet, nga ekspertët e shëndetit publik mbi këtë temë, studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare, mund të kontribuojnë duke përqendruar rolin e politikës në këtë diskutim. Diplomacia shëndetësore, ka dalë nga shëndeti publik dhe shpesh herë është përqendruar, në mënyrën se si diplomacia mund t'i shërbejë shëndetit, në politikën ndërkombëtare, veçanërisht nëse ajo ekzekutohet në mënyrë shumëpalëshe, me shtrirje globale , në baza rajonale dhe atë bilaterale.

Ky vit, ka paraqitur një sfidë të jashtëzakonshme, për diplomatët kosovar. Ndikimi i Pandemisë COVID-19, ndihet pothuajse në të gjitha fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, ka sfida të ndryshme për zhvillimin e diplomacisë dhe mënyrën se si punojnë diplomatët.⁹ Veçanërisht, në dritën e bllokimeve dhe distancimit shoqëror, diplomatëve iu desh të ndryshonin mënyrën e punës. Për diplomatët, nga vendet e vogla dhe ato në zhvillim, disa nga këto sfida u acaruan dhe u shfaqën sfida shtesë. Në muajin e fundit të vitit 2020, paraqiti një mundësi të mirë për të parë atë që ndodhi, por edhe për të parë atë që na pret në vitin e ardhshëm dhe madje edhe më gjerë. Debatet po zhvillohen në kontekstin, e projektit të ndryshme kërkimor, ku e ardhmja e diplomacisë

⁸ COUNCIL OF EUROPE (07 PRILL 2020), Dokument Informativ, Gjetur në:
<https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>

⁹ Helvetas, (Mars 2021) , Ndikimi I Covid-19, Gjetur në:

http://helvetas-ks.org/demos/wp-content/uploads/2021/03/Raporti-Covid-19_ALB_02.pdf

kosovare dhe ndryshimet në fushat e marrëdhënieve ndërkombëtare, në përgjigje të COVID-19. Praktikuesit diplomatikë, duhet të jenë krenar për atë që kanë arritur gjatë vitit 2020 në kohë pandemie, duke treguar se janë mjeshtër, të përshtatjes edhe në këtë kohë.

3.2. Mjedisi i punës në kushte pandemie në Kosovë

Bota e diplomacisë është veçanërisht, e prekur nga këto zhvillime, pasi takimet konferencat dhe ngjarjet e tjera të mëdha po anulohen. Për herë të parë, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), do të organizojnë takimet e tyre në internet.¹⁰ Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB), Bashkimi Europian (BE) dhe organizatat e tjera janë zhvendosur nga sallat e konferencave online, duke shkaktuar ndryshim të madhë në diplomaci. Kalimi i përshpejtuar, drejt takimeve dhe diplomacisë në internet, ka pasur ndryshime të mëdha:

- Platforma online, duhet të përmirësohet, për të ofruar stabilitet dhe siguri në diplomacinë Kosovare,
- Takimet ballë për ballë, duhet të përshtaten me dinamikën e reja online,
- Shumë nga rregullat e protokollit, duhet të rishikohen dhe ndryshohen.¹¹

Takimet, konferencat dhe ngjarjet e tjera në diplomaci, po ndryshohen dhe janë bërë më të rëndësishme pasi COVID-19, u përhap shpejt, duke i detyruar diplomatët dhe stafin diplomatik të respektojnë rregullat e distancimit. Qindra ngjarje në mbarë botën edhe në Kosovë, kanë bërë kalimin nga takimet e on-site në atë online për herë të parë.¹² Kriza shëndetësore COVID-19 është kthyer në një krizë ekonomike globale, duke vënë në

¹⁰ Qeveria e Kosovës, (Prill 2020). Vendimet e mbledhjes, Nr.01/07, Gjetur në: <https://kryeministri-ks.net/wpcontent/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%ABRepublik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

¹¹ Qeveria e Kosovës, (Prill 2020). Vendimet e mbledhjes Nr. 01/11. Gjetur në: <https://kryeministri-ks.net/wpcontent/uploads/2020/03/Vendimi-nr.01-11.pdf>

¹² Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

rrezik shëndetin, vendet e punës dhe të ardhurat e miliona njerëzve në mbarë botën.

Masat e rrepta të kontrollit të miratuara nga shumë vende në gjysmën e parë të 2020 për të rrafshuar rritjen e infektimit vendosin një frenim të konsiderueshëm në shumicën e aktiviteteve ekonomike dhe sociale. Rënia e orëve totale të punës dhe rënia e pjesëmarrjes nuk janë parë në kohë paqeje që nga depresioni i madh. Ka shenja se lugina e recesionit të mprehtë dhe të thellë ekonomik global është arritur në shumë ekonomi të G20-ës.

Megjithatë, siguri se rimëkëmbja është e shpejtë dhe e qëndrueshme, dhe rindërtimi i një tregu pune më elastik dhe gjithëpërfshirës, mbeten sfida të konsiderueshme.¹³

Në samitin e tyre më 26 mars 2020, udhëheqësit e G20 u angazhuan të bëjnë gjithçka që nevojitet për të kapërcyer këtë pandemi dhe pasojat e saj në ekonomi dhe shoqëri, dhe në veçanti, të mos kursejnë asnjë përpjekje për të mbrojtur vendet e punës dhe të ardhurat e njerëzve. Si pjesë e këtij angazhimi, udhëheqësit e G20-ës kanë kërkuar nga ILO dhe OECD të monitorojnë ndikimin e pandemisë në punësim. Ndërkohë, punëtorët me kontrata afatgjata kanë qenë ndër të parët që humbën punën gjatë krizës pasi kontratat që u mbaruan nuk u rinovuan. Rritja e kërkesave të reja për papunësi në mars dhe prill 2020 u nxit pothuajse tërësisht nga punonjësit e agjencive të përkohshme dhe punëtorët në punë të përkohshme, kontratat e të cilëve nuk u rinovuan. Në mënyrë të ngjashme, rënia e numrit të vendeve të punës midis fundit të shkurtit dhe fundit të prillit, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019, u shkaktua kryesisht nga reduktimi i punësimeve me kontrata me afat të caktuar, pavarësisht përpjekjeve për të pakësuar përkohësisht rregulloren ekzistuese për përdorimi i llojeve të tilla të kontratave.¹⁴

Prej muajit mars 2020 edhe kur filloi Pandemia COVID-19, besohet se në Kosovë, kanë humbur punën rreth 40 mijë persona, dhe se nëse vazhdon ky trend numri i atyre që do të humbin punën për shkak të pandemisë do të rritet deri në 60 mijë.¹⁵

¹³ GAP INSTITUTE. (2020), Impact of COVID-19 pandemic on local government, Gjetur në: https://www.institutigap.org/documents/23503_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20COVID19%20n%C3%AB%20pushtetin%20lokal.pdf?fbclid=IwAR1dMr4MX0cKS0q0bVJPhZ41oxi29w2IOejhrhMzUNjJOiXYdn5N_iqF30

¹⁴ COUNCIL OF EUROPE, (7 Prill 2020), Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Gjetur në: <https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>

¹⁵ Telegrafi (04.08.2020) Pandemia Covid-19 rreth 40 mije persona humben punen ne Kosove, Gjetur në: <https://telegrafi.com/pandemia-covid-19-rreth-40-mije-persona-humben-punen-ne-kosove/>

- **A po ndryshon COVID – 19, qasjen onsite në atë online?**

Patjetër se po, ndryshimet kanë ndodhur duke ndryshuar takimet onsite në atë online, duke kaluar më pak kohë në udhëtime dhe kostot më të ulëta të udhëtimit, duke vendosur çdo llojë të ngjarjes që do të organizohet dhe duke zgjedhur platformën, që i përshtatet nevojave specifike të takimeve diplomatike kosovare, “Life in Pandemics”.

- Si të organizoni dhe drejtoni takime online,
- Përditësime dhe njoftimi i konferencave në Diplomaci në webfaqe,
- Bashkohuni me konferencat e drejtpërdrejta, për të diskutuar në ndikimin e COVID-19,
- Përdorni kohën tuaj, duke mbajtur takime online në Diplomaci.¹⁶

Diplomacia bëhet më së miri, ballë për ballë dhe në hapsirat joformale për biseda, që i shtojnë negociatat përpara janë të dosmosdoshme, megjithatë mungesa e hapsirave joformale heq mjetet e rëndësishme për arritjen e konsensusit. Andaj shqetësimet në lidhje me ngarkesën e punës, për vitin 2020 dhe 2021 dhe aftësinë që vendet e vogla dhe ato në zhvillim të marrin përsipër këtë ngarkesë me delegacionin kosovar relativisht më të vogël dhe më pak ekspertë. Diplomatatë fituan aftësi të reja në lundrimin dhe përdorimin e mjeteve dixhitale për komunikim dhe takime. Janë krijuar forma dhe opsione të reja për takime – veçanërisht forma hibride (online) takimesh, ku disa pjesëmarrës takohen në vend, ndërsa të tjerët marrin pjesë në distancë, kjo teori do të praktikohet edhe pas Covid-19.¹⁷ Në mënyrë për të parë raportimin diplomatik është ta konsideroni atë si një aspekt dukurie më të gjerë dhe më të përgjithshme, në rrjedhën e informacionit. Transmetimi i informacionit është një aktivitet themelor i njeriut që në një formë ose në një tjetër zhvillohet gjatë gjithë kohës dhe në rrethana të shumta.¹⁸ Si çdo metodë tjetër e rrjedhës së informacionit, raportimi diplomatik duhet të ketë strukturën e vet të dallueshme.

¹⁶ Sbunker (15 Prill 2020). Diplomacia në kohën e Covid19. Gjetur në: <https://sbunker.net/op-ed/90471/diplomacia-ne-kohen-e-covid19/>

¹⁷ Alhashimi, Hana. The Future of Diplomacy after COVID-19. *Multilateralism and the Global Pandemic*. Routledge, Taylor & Francis Group. England.UK. 2021 (fq.18)

¹⁸ Friedrich Erbert Stiftung (Dhjetor 2021). Perspektiva e përgjithshme: Agjenda ekonomike progressive për Kosovën, Gjetur në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/19202.pdf>

Ajo duhet të dalë nga një kontekst i përcaktuar qartë dhe ka nevojë për drejtim dhe qëllim, andaj duhet të përdorë çfarëdo mjeti komunikimi që është aktualisht në dispozicion.

Dy aspekte të kundërta karakterizojnë rrjedhën e informacionit në çfarëdo forme që ai kryhet. Nga njëra anë, kur informacioni ekziston, ekziston nevoja dhe tendenca e natyrshme që ai të rrjedhë jashtë, dikush mund ta vendos këtë në një mënyrë tjetër.

Ekziston nevoja për një marrës njerëzor, po aq sa një transportues njerëzor, që faktet dhe ngjarjet të bëhen informacion.

Prandaj, synimi themelor është që të gjitha llojet e raportimeve, duke përfshirë raportimin diplomatik, të bëhen të hapur dhe të pakufizuar.¹⁹ Çështja është se deri në çfarë mase ka kufij për këtë hapje, dhe për më tepër kush vendos për këto kufij. Mbajtja e informacionit është një mjet për një individ ose një grup individësh për të ushtruar kontroll mbi të tjerët.

Në përgjithësi, teknologjia ka qenë në anën e lëvizjeve drejt rrjedhës më të lirë të informacionit, megjithëse herë pas here është përdorur edhe për qëllime të kundërta.

Zbulimi i madh erdhi me shpikjen e shtypjes. Dikush mund të kthehet edhe më tej, te shpikja e shkrimit. Zbulimi i fundit përfaqësohet nga interneti. Është e dobishme ta vendosim fenomenin e internetit në këtë kontekst historik. Në mënyrën se si po evoluon, Interneti është pjesë e garës shekullore që tregon drejt një fluksi më të lirë dhe më të hapur informacioni.

Është thënë shpesh se gjuha nuk është vetëm një instrument komunikimi, por vetë thelbi i diplomacisë. Diplomatat angazhohen në negociata, bindje, prezantim dhe komunikim, të cilat të gjitha kërkojnë aftësi gjuhësore për kryerjen efektive të punës diplomatike. Si gjuha e shkruar ashtu edhe ajo e folur kërkojnë zotërimin e koncepteve dhe aftësive dhe duhet të marrin në konsideratë mesazhin dhe kontekstin.²⁰ Gjuha mund të shërbejë gjithashtu si një formë veprimi: kur paralajmërojmë, kërcënojmë, premtojmë, sugjerojmë, pajtohemi, këshillojmë ose ndryshe, ne jemi duke bërë diçka, dhe jo thjesht duke thënë diçka. Roli i të pathënave në komunikim (heshtja kuptimplotë) është po aq vendimtar.

¹⁹ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

²⁰ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

Gjuha është po aq e rëndësishme sot sa ishte për të dërguarit dhe negociatorët e parë. Sot, teknologjia po formëson vazhdimisht aspekte të caktuara të gjuhës dhe diplomacisë, me futjen e mjeteve të reja për komunikim dhe interpretim, mënyra të reja të kapjes dhe ruajtjes së dokumenteve diplomatike dhe metodave që lehtësojnë negociatat në internet. Vëmendje e madhe i kushtohet rasteve studimore të traktateve, fjalimeve presidenciale, njoftimeve publike, reklamave qeveritare dhe materialeve mediatike, në mënyrë që të lidhet diskutimi teorik me shembuj praktikë. Meqenëse komunikimi efektiv ka të bëjë shumë me qëllimet dhe kontekstet e leximit në mënyrë korrekte, jepen njohuri për variablat përkatëse kulturore, sociale dhe psikologjike.²¹

Megjithatë, gjuha mund të shërbejë edhe si një formë veprimi. Teoria e aktit të të folurit tregon se jo vetëm fjalët kanë fuqinë për të shkaktuar veprime, por shumë thënie janë një formë veprimi në vetvete.

Qasjet ndaj gjuhës, si veprim është shumë domethënëse për diplomacinë, pasi konfirmon se ndërhyrjet dhe komunikimet diplomatike nuk janë thjesht një mjet për një qëllim, por mund të jenë qëllime në vetvete: diplomatët veprojnë mbi botën përmes gjuhës. Prandaj është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë saktësisht po bëjnë ata me anë të gjuhës që përdorin. Teoria e aktit të të folurit na fton të bëjmë dallimin midis një akti të të thënit të diçkaje, asaj që bën duke e thënë atë dhe asaj që arrihet duke e thënë atë. Ai gjithashtu bën dallimin midis akteve të të folurit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Veprimet e të folurit të drejtpërdrejtë ose shënohen me fraza të caktuara si për këtë, ose me përmendje të qartë, si të premtoj, të paralajmëroj, etj. Në rastin e akteve të të folurit indirekt, qëllimi i folësit duhet të nxirret nga kontekst.²²

Do të jetë e rëndësishme, të mësojmë dhe të jetojmë me këtë pasiguri dhe të përshtatemi me jetën normale të re, duke sygjeruar që besimi dhe ndërtimi i besimit duhet të jenë në qendër të vëmendjes për secilin nga ne.

²¹ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

²² Qeveria e Kosovës, (Prill 2020). Vendimet e mbledhjes, nr.01/07, Gjetur në: <https://kryeministri-ks.net/wpcontent/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%ABRepublik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

Ndërsa ne, duhet të përshtatemi me mënyrat e reja të punës dhe është thelbësore që ta mbajmë gjithëpërfshirjen në qendër të përpjekjeve tona.²³

Shkëmbimet në internet, janë dëshmuar të jenë më informale dhe më pak miqësore në protokolin diplomatik, ndërsa humbja e disa aspekteve të traditës diplomatike dhe disa rregulla të angazhimit duhet të mbesin. Protokoli dhe ritualet diplomatik, mbrojnë rolin unik të diplomatëve, si përfaqësues të vendeve të tyre dhe janë thelbësore për t'i lejuar ata të angazhohen me homologët e tyre pavarshisht pozicioneve dhe interesave kombëtare të ndryshme dhe konfliktuale. Ndërsa këto sfida, do të vazhdojnë ta bëjnë të vështirë artin e diplomacisë, por nuk ka kthim prapa, sepse jemi në pandemi.

Ne duhet të përshtatemi dhe të adoptojmë më të mirën e të dy botëve: një diplomaci hibride të re, që kombinon takimet ballë për ballë dhe ato online. Mënyra se si përshtatet diplomacia në hapsirat e takimeve në internet, do të jetë kritike në adresimin e çështjeve të tjera thelbësore për njerëzimin, nga lufta ndaj ndryshimeve klimatike deri te sigurimi i paqës dhe trajtimi i çështjeve të tjera globale për vitet në vijim, pasi që kemi hyrë në vitin e tretë të pandemisë dhe duhet shqyrtuar me vëmendje.

Për delegacionet më të vogla, ka kufizime në onsite dhe duhet të adresohen vetëm online, por qëllimi përfundimtar është të sigurohet pjesëmarrje kuptimplotë, në të dyja format. Ne jemi dëshmitarë të përfshirjes, së aktorëve kryesorë të teknologjisë në diplomacinë kosovare, të cilët po eksplorojnë dhe shfrytëzojnë potencialin, e inteligjencës artificiale. Të dhënat, e mëdha dhe teknologjive të tjera në zhvillim në parashikimin, monitorimin dhe parandalimin e efekteve negative të krizës. Takimet, konferencat dhe ngjarjet e tjera në internet janë bërë më të rëndësishme, pasi COVID-19, përhapet shpejt duke i detyruar njerëzit të respektojnë rregullat e distancimit shoqëror.²⁴

Platformat e të dhënave në internet, po përdoren për të ndjekur përhapjen e pandemisë në të gjithë botën. Në këtë hapsirë ndahen këshilla se si të organizonin takime në internet, si të kaloni në një mjedis pune në internet, si të bëni më të mirën e mësimin në internet dhe cilat mjete të përdorni për nevoja të ndryshme.

²³ COUNCIL OF EUROPE, (7 Prill 2020), Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Gjetur në: <https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>

²⁴ Peter Van Aelst, Jay G. Blumler. Political Communication in the Time of Coronavirus. Taylor & Francis, 2021. (fq.189)

Për më tepër, moderimi i cili varet nga një përzierje e zgjuar e aftësive të vjetra dhe të reja duhet të konsiderohet si pika e kthesës, që krijon një përvojë unike në internet. Diplomatët kosovar dhe ata të mbarë botës, janë kthyer punës online, duke rritur kohën e kaluar në internet dhe duke mjegulluar kufirin midis punës dhe jetës familjare.

Video konferencat filluan, pas shpërthimit të pandemisë, duke dhënë pamje të një llojë tjetër në revolucionin diplomatik, ku po zhvillohen bisedime në Zoom, duke mbajtur takime virtuale.²⁵

3.3.Çfarë është Diplomacia Shëndetësore?

Pjesërisht për shkak se shumica e literaturës mbi diplomacinë shëndetësore, ka dalë nga shëndeti publik dhe jo nga shkenca politike ose marrëdhëniet ndërkombëtare, ajo shpesh është përqëndruar në mënyrën se si diplomacia mund t'i shërbejë shëndetit, në politikë. Literatura ekzistuese, mbi diplomacinë shëndetësore sugjeron, dy dallime që studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare mund të dëshirojnë të bëjnë.²⁶

E para, i referohet tensionit, midis qëllimeve të rritjes së shëndetit publik global nga njëra anë dhe shërbimit të interesit kombëtar, sido që të jetë përcaktuar, nga ana tjetër. Dallimi i dytë, i referohet mjeteve të diplomacisë shëndetësore, veçanërisht nëse ajo ekzekutohet në mënyrë shumëpalëshe, me një shtrirje globale, në baza rajonale ose bilaterale.²⁷

Historikisht diplomacia shëndetësore, ka mbetur në periferi të marrëdhënieve ndërkombëtare. Nga iniciativat rajonale të Bashkimit European ka dhënë shembuj të shumtë, të shteteve që përqendrojnë shëndetin në politikën e jashtme.

Në aspektin e qëllimeve, të diplomacisë është reflektuar deri diku në llojin e diplomacisë shëndetësore që përcaktohen, qëllimet e diplomacisë globale të shëndetit si përmirësimi i

²⁵ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

²⁶ Kickbusch, I., Lister, G., Told, M., Drager, N. (Eds.). Global Health Diplomacy. *Concepts, Issues, Actors, Instruments, Fora and Cases*. Springer. New York. USA. 2013.(fq.159)

²⁷ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

shëndetit global. Këto përpjekje duhet të përqendrohen në institucionet globale, si OBSH, objektivi i deklaruar i së cilës është "arritja nga të gjithë popujt, e nivelit më të lartë të mundshëm të shëndetit."

Përpjekjet e diplomacisë nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, bazohen në diçka të ngjashme duke u përqendruar në institucionet globale të OBSH-së, objektivi i deklaruar i së cilës është arritja nga të gjithë popujt, e nivelit më të lartë të mundshëm të shëndetit.²⁸

Historia e fundit, e shpërthimeve të sëmundjeve infektive të shekullit të XXI, sugjeron një largim të mundshëm nga diplomacia shëndetësore, me pjesëmarrje globale.

Për shembull, duke e përshkruar diplomacinë shëndetësore, si mekanizëm për të menaxhuar rreziqet shëndetësore brenda dhe jashtë çdo vendi.

Diplomacia shëndetësore, ndahet në dy dallime të marrëdhënieve ndërkombëtare:

- Tensioni ndërmjet qëllimeve, duke mbështetur shëndetin publik global nga njëra anë dhe duke i shërbyer interesit kombëtar në anën tjetër,
- Shëndeti i diplomacisë, veçanërisht nëse ajo zbatohet në mënyrë shumëpalëshe, me shtirje globale në baza rajonale dhe dypalëshe.

Përpjekjet drejt veprimit të koordinuar global, shëndetësia do të kërkojë që kuadri ynë i trajnuar tradicionalisht i diplomatëve, të cilët veprojnë brenda kufijve të ministrive tona të punëve të jashtme dhe kështu janë mësuar të negociojnë vetëm me diplomatë të tjerë, duke u bërë pjesë e transformimit që aktualisht është duke u zhvilluar.²⁹ Në rastet kur përpjekjet diplomatike mund të tensionohen ose negociatat janë të vështira për t'u arritur, diplomacia shëndetësore mund të hapë dyert për të nxitur dialogun e ri dhe për të krijuar më shumë partneritete në një nivel jopolitik.

Nga ana tjetër, Shërbimet Njerëzore, sjellin ekspertizën teknike dhe kërkimin shkencor shumë të nevojshëm në fushat e ndërlidhura të shëndetit publik dhe zhvillimit ndërkombëtar. Duke shkëmbyer njohuri shkencore dhe të bazuara në prova me drejtues

²⁸ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Departamenti për Diplomaci ekonomike, Gjetur në:

<https://www.mfa-ks.net/al/ministria/534/departamenti-pr-diplomaci-ekonomike/534>

²⁹ Qeveria e Kosovës, (Prill 2020). Vendimet e mbledhjes, nr.01/07, Gjetur në:

<https://kryeministri-ks.net/wpcontent/uploads/2020/03/Vendimet-e-Mbledhjes-s%C3%AB-7-t%C3%AB-t%C3%AB-Qeveris%C3%AB-s%C3%ABRepublik%C3%ABs-s%C3%AB-Kosov%C3%ABs-2020.pdf>

dhe edukatorë shëndetësorë jashtë vendit, duke vazhduar të maksimizojnë objektivat e tyre në siguri, zhvillim dhe shëndet. Diplomacia e sotme shëndetësore më shumë se kurrë më pare, përfshin një shumëllojshmëri të aktorët, jo të gjithë janë përfaqësues të shtetit dhe ndodhin në vende të ndryshme, formale dhe joformale, në nivele të ndryshme. Aktorët joshtetërorë ndihmojnë jo vetëm në formësimin e përgjigjeve të politikave të marra nga qeveritë ndaj sfidave të sotme globale, por gjithashtu mund të luajnë një rol aktiv rolin në negociatat e ndërmarra për t'iu përgjigjur këtyre sfidave.³⁰

Ndikimi i aktorëve joshtetërorë që komandojnë sasi të mëdha të burimet, veçanërisht ato financiare, janë në rritje. Ata mund të ushtrojnë politikë presion mbi qeveritë që është e vështirë të injorohet dhe të cilat mund të drejtohen kundër të mirës së përgjithshme publike.

Diplomatët tradicionalë kërkojnë ndihmën dhe angazhimin aktiv të shëndetësisë ekspertë të tillë si ju për të hartuar dhe negociuar korniza dhe marrëveshjet që mund të adresojnë sfidat globale të shëndetit. Ka një numër në rritje vendesh që janë bërë gjithnjë e më shumë të angazhuar në politikat shëndetësore dhe duke njohur vlerën e integritimit të shëndetit në të gjitha politikat e qeverisë.³¹ Ne duhet të rrisim përfshirjen dhe koherencën e politikave ndërmjet, forumeve diplomatike dhe të shëndetit publik, për të përmirësuar të kuptuarit tonë, në ndërlidhjet ndërmjet politikës së jashtme dhe shëndetit global.

Kornizat e përbashkëta dhe njohja e avantazheve krahasuese të të dy sektorët, për të ndjekur rezultate më të mira shëndetësore, do të rrisin shanset për sukses në arritjen e rezultateve.

Unë shoh gjithashtu nevojën e strategjive formale, të gjithë qeverisë dhe proceset e koordinimit, të cilat ofrojnë një mënyrë sfiduese për përmirësimin e jashtëm të politikave, aftësitë dhe performanca në shëndetin global.³²

³⁰ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

³¹ Konrad Adenauer Stiftung - Oda Ekonomike e Kosovës (Dhjetor 2020), Ndikimi I Covid-19, në transformimin digjital, Gjetur në: <https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy+Brief+20-12-11+The+Impact+of+COVID-19+on+Digital+Transformation+%28ALB%29.pdf/a483bea7-5842-2228-df54-02b7f1cd58eb?version=1.0&t=1609943350354>

³² Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

Kjo do të kërkojë bashkëpunim ndërsektorial ndërmjet disa ministrive, duke përfshirë shëndetësinë, transportin, arsimin, tregtinë, turizmin, planifikimi dhe zhvillimi.

Në kuadër të këtij konstrukti të koordinuar diplomatik, Ministritë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, duhet ta shoh veten jo si praktikuesit e vetëm të diplomacisë, por më tepër si pjesë e një sistemi të ri kombëtar diplomatik.³³

Pika e fundit që do të theksoja është lidhja ndërmjet popullsinë vendase dhe shëndetin publik global. Ekziston një lidhje ndërmjet çështjeve globale të shëndetit dhe atyre në nivel vendor.

Prandaj, besueshmëria e avokimit në skena ndërkombëtare do të ndikohet nga politikat e jashtme në zhvillim dhe të zbatohet në shtëpi.

³³ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Departamenti për Diplomaci ekonomike, Gjetur në:
<https://www.mfa-ks.net/al/ministria/534/departamenti-pr-diplomaci-ekonomike/534>

KAPITULLI II

4. Pandemia COVID -19 dhe diplomacia Kosovare

Shtetet janë mbyllur, duke anuluar të gjitha vizitat shtetërore, udhëtimet zyrtare komunikimet fizike të gjitha janë kufizuar me pandemin COVID-19, "Life in Pandemics". Politikat e jashtme, diplomacia dhe diplomatët, janë duke kërkuar forma të reja digjitale për të vazhduar marrëdhëniet me shtetet e tjera dhe institucionet multilaterale edhe në këtë kohë pandemie.

Takimet janë bërë të pamundura fizikisht, atëherë duhet patjetër të bëhet në mënyrë virtuale.³⁴ Në të njëjtën kohë, ka sfida të ndryshme për zhvillimin e diplomacisë dhe mënyrën se si punojnë diplomatët. Veçanërisht, në dritën e bllokimeve dhe distancimit shoqëror, diplomatëve kosovar, iu desh të ndryshonin mënyrën e punës.

Pandemia globale, po ndryshon tërësisht në politikën e jashtme, diplomacia tradicionale thuhet se bashkëjeton me atë digjitalen ku gjithmonë është në rritje. Është e qartë se bisedimet po zhvillohen, përmes video-konferencave diplomatike, si formë negociuese e bisedimeve. Pas një rritje të re të virusit, detyrohen, që takimet të mbahen virtuale. Bisedimet e reja rreth pandemisë COVID-19, filluan midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Bashkimit Europian (BE), në mënyrën ballë për ballë në qershorin 2020, duke bërë të qartë kompromiset, me ndjeshmëri të madhe politike, duke bërë urgjente dhe ato përfunduan me sukses në dhjetor 2020. Marrëveshja tregëtare e bisedimeve SHBA dhe Britania e Madhe u mbajtë me video-konferencë nga muaji maj 2020, duke pasur përparim të mirë dhe serioz, për të përfunduar para zgjedhjeve presidenciale amerikane në nëntor 2020.³⁵ Megjithatë kjo nuk është dëshmi përfundimtare e me ndonjë vlerë të videokonferencës, ndërhyrja e Ambasadës Britanike në Uashington dhe Ambasada Amerikane në Londër, pa dyshim mund të flitet për shumë negociata të tjera dypalëshe, duke udhëhequr delegacionin dhe disa

³⁴ Ministria e Shëndetësisë, (Maj 2021), Projekti Emergjent Covid-19 në Kosovë, Gjetur në:

https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/05/ALB-SEP-Projekti-Emergjent-COVID-19_Kosove-P173819_compressed.pdf

³⁵ Konrad Adenauer Stiftung - Oda Ekonomike e Kosovës (Dhjetor 2020), Ndikimi I Covid-19, në transformimin digjital, Gjetur në :

<https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy+Brief+20-12-11+The+Impact+of+COVID-19+on+Digital+Transformation+%28ALB%29.pdf/a483bea7-5842-2228-df54-02b7f1cd58eb?version=1.0&t=1609943350354>

këshilltarë kryesorë marrin role kryesore në ekran dhe është e rëndësishme që ata të vulojnë dukshëm ndikimin e tyre në procedurat gjatë pandemisë.

Diplomacia kosovare natyrisht, nuk ka të bëjë vetëm me negocimin e marrëveshjeve por edhe në mbështetje të funksioneve të saj.³⁶

Në sigurimin e formave të ndryshme të mbështjetjes së negociatave, ballë për ballë dhe zgjidhjen e çështjeve të pakontestueshme, që video-konferenca të luan rol të vlefshëm. Në marrëdhëniet midis aleatëve dhe miqëve, në nivelin më të lartë politik, këtu përfshihet dhënia e mesazheve të solidaritetit dhe konfirmimin e kordinimit të veprimeve të dakorduara tashmë. Në nivelet më të ulëta të qeverisjes duke përfshirë lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe zgjedhjen e çështjeve teknike dhe procedurale.³⁷

Në takimin e thirrjeve të videokonferencës, sigurisht që filluan pas shpërthimit të pandemisë, në lehtësimin e shkëmbimit të informacionit dhe komunikimit të përbashkët në mes të vendeve.

Në mesin e krizave aktuale mjedisore, socio-ekonomike dhe shëndetësore, është thënë shumë në lidhje me kërcënimet ekzistenciale të njerëzimit me COVID-19, Kosova u përball edhe me zgjedhjet parlamentare, që u mbajtën me 14 shkurt 2021.

Pandemia, ka zbuluar brishtësinë e shoqërive tona dhe sa e pashmangshme dhe e domosdoshme është ndërruesia në mes njëra tjetrës.

Pandemia COVID-19, jep shumë shembuj ndaj kritikave të përhapura të Organizatës Botërore të Shëndetit deri tek rritja e ndihmës dypalëshe shëndetësore dhe krijimi i një iniciative rajonale të vaksinave.³⁸

Megjithatë diplomacia shëndetësore, ka ngjarë të jetë më pak efektive, duke pasur parasysh, nevojën e zbutjes dhe frenimit global.

³⁶ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

³⁷ Konrad Adenauer Stiftung - Oda Ekonomike e Kosovës (Dhjetor 2020), Ndikimi i Covid-19, në transformimin digjital, Gjetur në: <https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy+Brief+20-12-11+The+Impact+of+COVID-19++on+Digital+Transformation+%28ALB%29.pdf/a483bea7-5842-2228-df54-02b7f1cd58eb?version=1.0&t=1609943350354>

³⁸ Hotez, J. Peter. Preventing the Next Pandemic. Vaccine Diplomacy in a Time of Anti-science. Baltimore. Maryland. USA. John Hopkins University Press. 2021 (fq.158)

Diplomacia shëndetësore, si bashkëpunim ndërkombëtar, synon promovimin e shëndetit duke përdorë programin shëndetësor, për të promovuar qëllimet e huaja që nuk lidhen me shëndetin.³⁹

Ritmi i shtuar i pandemive në shekullin e XXI, i ka vendosur zgjedhjet e shteteve në zbatimin e diplomacisë shëndetësore, në një lehtësim të mprehtë. Natyra e pandemive, kërkon bashkëpunim ndërkombëtar, për zbutjen dhe frenimin e COVID-19.

Por pandemitë gjithashtu krijojnë mundësi për shtetet, që të ndjekin qëllimet e politikës së jashtme, që kryesisht i shërbejnë interesit të tyre kombëtar, në vend që t'i shërbejnë shëndetit global.⁴⁰

³⁹ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

⁴⁰ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

4.1. Ndikimi i pandemisë në diplomaci

Diplomacia kosovare, përjetojë ndryshime dhe vështirësit nga ndikimi i pandemisë, “korona virus”. Viti 2020 ishte gjithashtu një vit i zhvillimeve të rëndësishme politike dhe zgjedhjeve në mars, me fillimin e krizës, qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Albin Kurti, u rrëzua nga mocion i mosbesimi i iniciuar nga partneri i saj i koalicionit LDK.⁴¹

Qeveria ndërmori kufizime edhe para se të shfaqeshin, rastet e para të Covid-19 në Kosovë, masat u bënë më të rrepta, më 15 mars, gjendja u shpall emergjente, e cila qëndroi në fuqi deri në mes të majit 2020. Kriza pandemike në Kosovë, ka krijuar polarizim social, për shkak të përplasjeve të vazhdueshme politike, duke refuzuar për të votuar për ndryshimet ligjore apo iniciativat e nevojshme, për të menaxhuar siç duhet krizën shëndetësore.

Në përgjithësi, besimi i publikut ndaj institucioneve qeveritare, gjatë pandemisë ka qenë i qëndrueshëm dhe masat u zbatuan nga qeveria, u respektuan në masë të madhe edhe nga populli. Remitancat, kanë shënuar rënie në shumicën e vendeve të rajonit, përveç Kosovës.

Qeveria Kurti, kërkojë nga diaspora kosovare, për të dhuruar para, duke marrë me më shumë se 720,000.00 euro të dhuruara nga diaspora për Kosovën. Kjo rikonfirmon rolin kyç të diasporës dhe gatishmëria për të kontribuar në kohë krize, por është edhe tregues i besimit që i është dhënë qeverisë së Kurtit, për ta menaxhuar këto fonde.⁴²

Megjithatë, pasiguria mes qytetarëve u rrit për shkak të rënies së qeverisë, e cila u largua nga vendi publiku i pasigurt se si do të trajtohej pandemia. Kosova për herë të parë, po përballlet me një recesion të rëndë ekonomik, në dy dekada.⁴³ Rënia e vazhdueshme e investimeve dhe e konsumit privat si dhe e eksporteve të shërbimeve kanë thelluar tkurrjen

⁴¹ Deutsche Welle (25 Mars 2020), Kosovë: Rrezohet qeveria e Albin Kurtit synohet krijimi i një qeverie te perkohshme, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-rr%C3%ABzohet-qeveria-e-albin-kurtit-synohet-krijimi-i-nj%C3%AB-qeverie-t%C3%AB-p%C3%ABrkohshme/a-52919184>

⁴² Kosova live, (22 Maj 2020), Kurti: 720 mije euro janë mbledhur nga diaspora në fondin emergjent të qeverisë, Gjetur në: <https://kosova.live/kurti-720-mije-euro-jane-mbledhur-nga-diaspora-ne-fondin-emergjent-te-qeverise/>

⁴³ GAP INSTITUTE. (2020), Impact of COVID-19 pandemic on local government, Gjetur në: https://www.institutigap.org/documents/23503_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20COVID19%20n%C3%AB%20pushtetin%20lokal.pdf?fbclid=IwAR1dmr4MX0cKS0q0bVJPhZ41oxj29w2IOejhrhMzUNij0iXYdtN5N_iqF30

ekonomike, gjatë viteve 2020-2021.

Duke u mbështetur, gjithmonë në aleatin më të afërt të Kosovës, në Shtet e Bashkuara të Amerikës (SHBA), përveç mbështetjes politike dhe diplomatike, si shoqëri multietnike, demokratike e integruar plotësisht në bashkësinë ndërkombëtare.

Marrëdhëniet me Shtet e Bashkuara të Amerikës, gjithmonë mbetet prioritet i vazhdueshëm i politikës së jashtme. Politika e jashtme e SHBA-së, është fokusuar edhe ndaj pandemisë COVID-19, duke dhuruar Kosovës edhe vaksinat .⁴⁴

Mungesa e kontaktit njerëzor, shpesh citohet si kryesore në diplomaci. Sfidatat e mëdha të muajve të parë dhe gjatë gjithë pandemisë, ishte mungesa e hapsirave informale të takimeve.

Ndikimi kryesor në diplomaci, mund të themi se ishte edhe ai i komunikimit, ku diplomatët mund të flasin zyrtarisht, duke u zhvendosur në internet gjatë pandemisë.

Ndërtimi i komunikimit, i besimit në diplomaci dhe kapaciteti i përgjithshëm social, kërkon praninë fizike dhe ndërveprimin ballë për ballë.

Duke u mbështetur në këtë, ndërveprimet virtuale të shoqëruara me takime, të herë pas hershme, ballë për ballë, mund të sigurojnë vazhdimin e praktikës diplomatike.

Siç u përmend, hapësirat joformale, fizike janë vendimtare për negociatat diplomatike.

Megjithatë është gjithashtu, e qartë se mungesa e atyre hapësirave, nuk mund të nënkuptojnë se negociatat të ndahen plotësisht në videokonferenca.

Negociatat duhet të zhvillohen njëkohësisht, me të gjithë pjesëmarrësit, që janë në të njëjtën pozitë diplomatike, negociatat janë zhvilluar me videokonferenca si hartimi i dokumenteve të përbashkëta.

Nivelin praktik, rritja e përdorimit të videokonferencave, solli një sere sfidash, shqetësimet më të mëdha që diplomatët shprehën ishin: trajtimi i çështjeve teknike, zgjidhja e çështjeve të sigurisë dhe duke ju përshtatur, ndryshimeve në komunikim dhe negocim, çështje tjetër dhe sfidat është ajo që lidhet me shërbimet e përkthimit.⁴⁵

⁴⁴ Anadolu Agency Ballkani, (11 Shkurt 2022), SHBA i dhuron Kosovës mbi 500 mijë doza të vaksinave Pfizer, Gjetur në: <https://www.aa.com.tr/sq/ballkani/shba-ja-i-dhuron-kosov%C3%ABs-mbi-500-mij%C3%AB-doza-t%C3%AB-vaksinave-pfizer/2500033>

⁴⁵ Sbunker (15 Prill 2020). Diplomacia në kohën e Covid19. Gjetur në: <https://sbunker.net/op-ed/90471/diplomacia-ne-kohen-e-covid19/>

Nuk duhet të harrojmë, se negociatat me video konferenca, gjithashtu kanë implikime për përfshirjen dhe transparencën.

Zhvendosja e ndërveprimit diplomatik nga ambasadat, ndaj ministrave dhe krerëve të shteteve filloi, të ndodhte me diplomaci telefonike, dekada më parë.

Duke u përshpejtuar në epokën dixhitale edhe më tej gjatë Pandemisë COVID-19.⁴⁶

Përvoja dyvjeçare ofron bazë të mjaftueshme, që do të ndihmonte në zgjedhjen e llojit më të përshtatshëm të takimit, për negociatat apo aktivitetet e tjera diplomatike. Në bazë të këtyre kriterëve, gjatë takimeve duhet të theksohet, rëndësia politike, kërkesat ligjore dhe procedurale, niveli i përfshirjes, i sjelljes dhe aspektet emocionale.

Diplomacia hibride, kërkon rregullime gjithëpërfshirëse, të organizatave ndërkombëtare dhe diplomatike. Struktura organizative duhet të rregullohet, në mënyrë që të lehtësohen format e reja të angazhimit dhe ndërveprimit.

Aktivitetet trajnuese, të akademive diplomatike dhe organizatat e tjera, të trajnimit duhet të ofrojnë njohuri dhe kuptime duke përfshirë moderimin e negociatave dhe raportimin e takimeve.

Diplomatët tani më shumë se kurrë, kanë nevojë të kenë njohuri me mjetet e videokonferencave, për të bërë zgjedhje, të informuara dhe kanë nevojë për një përgjegjësi, të shtuar për çështjet e sigurisë kibernetike ndaj të dhënave.⁴⁷

Fillimisht, shumë diplomat donin të riktheheshin në normalitet, sa më shpejt të ishte e mundur.

⁴⁶ Sbunker (15 Prill 2020). Diplomacia në kohën e Covid19. Gjetur në:
<https://sbunker.net/op-ed/90471/diplomacia-ne-kohen-e-covid19/>

⁴⁷ Minisitria e punëve të Jashtme dhe Diaspores, Diplomacia Digjitale Gjetur në:
<https://www.mfa-ks.net/politika/486/diplomacia-digjitale/486>

4.2. Diplomacia shëndetësore në pandemitë e kaluara

Pandemia kërkon një përgjigje globale, veçanërisht duke pasur parasysh nivelin e sotëm të lartë të globalizimit. Kordinimi global, gjatë shpërthimit të pandemisë i cili shpesh bëhet si krahasim me COVID-19, por mjekësia, shëndeti publik, pandemia dhe qeverisja globale kanë bërë të gjitha një rrugëtim të gjatë. OBSH-ja, në bashkëpunim me SHBA dhe Bashkimin Sovjetik, kryesuan një përpjekje të përbashkët, përmes OBSH-së, për të zhdukur Pandemin Covid – 19. Burimet e konsiderueshme të mbikqyrjes së shëndetit global, u krijuan gjatë dhe u rishikuan në vazhden e epidemisë SARS, në 2003 dhe përgjigjen globale ndaj Ebola, në Afrikën Perendimore në 2014.

Ndërsa investimet shpesh bëhen në mënyrë bilaterale dhe multilaterale, shtetet dhe organizatat e tjera duhet të vendosin për burimet e kufizuara.⁴⁸

COVID – 19, u shfaq në Wuhan, Kinë në fund të vitit 2019 dhe u përhap shpejt, pothuajse në çdo vend të botës. Ka pas mbi 18 milion raste të infektuar, me COVID-19 globalisht dhe 700,000 vdekje. OBSH-ja, është akuzuar për pakujdesi përballë Kinës, duke nënvlerësuar seriozitetin dhe nivelet e transmetimit të COVID-19 në fillimin e saj, dhe duke lavdëruar Kinën, për përgjigjen e saj fillestare ndaj shpërthimit. Pandemia aktuale Covid-19, është karakterizuar gjithashtu edhe si një diplomaci më e madhe shëndetësore dypalëshe, ndonjëherë në mënyra befasuese.⁴⁹ COVID-19, jep shumë shembuj të ndryshëm të diplomacisë shëndetësore, por kryesisht karakterizohet nga një seri përgjigjesh rajonale, të tilla si një nismë e BE -së për vaksinat e pavarur nga OBSH-ja.⁵⁰

Universi i lirë, i rasteve ishte shpërthim i sëmundjeve të reja të shekullit të XXI, të përhapur kryesisht nga kontakti. Duke e kufizuar analizën dhe sëmundjen e përhapur nga kontakti, person për person apo B2B me Covid-19.

Në rishikimin e diplomacisë, së kaluar shëndetësore kishim rreth pesë shpërthime:

- SARS në 2003,
- H1N1 në 2009,

⁴⁸ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Tiranë, (Prill 2020). Situata e Pandemisë Covid-19, Gjetur në: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Urdhri-254-per-protokoll-strehezat..pdf>

⁴⁹ Wikipedia, (Mars 2020), Pandemia Covid 19, Gjetur në: https://sq.wikipedia.org/wiki/Pandemia_e_COVID-19

⁵⁰ Wikipedia (Mars 2020), Covid-19, Gjetur në: <https://sq.wikipedia.org/wiki/COVID-19>

- MERS në 2012,
- Ebola në Afrikën Perendimore në 2014
- Ebola në Republikën Domenikane të Kongos në 2018.

Konkluzioni i kësaj, është të identifikojnë qëllimet strategjike të vendeve, të përfshira në një diplomaci shëndetësore.

- **Sars në 2003**

Fillimisht ishte diagnostifikuar, si grip në provincën e Guangdong të Kinës. U përhap në mbi njëzet e pesë (25) vende, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH), shërbeu si organizatë kordinuese dhe mbikëqyrëse në rastin e SARS, duke ngritur alarmin për shpërthim global. Sars 2003, mori jetën e 774 njerëzve ndërsa janë infektuar 8,469.⁵¹

- **H1N1 në 2009**

Epiqendra e shpërthimit të H1N1 në vitin 2009 ishte Meksika. Nga mesi i vitit 2009, ishte përhapur në mbi 150 vende dhe deri në 2018, H1N1 mori jetën e 75,000 mijë njerëz ndërsa janë infektuar rreth 100.5 milionë.⁵²

- **MERS në 2012**

Rastet e para të njohura të Sindromës së Frymarrjes së Lindjes së Mesme (MERS), u shfaqen në Arabinë Saudite dhe në Mbretërinë e Bashkuar në 2012. Afër tridhjetë (30) vende kanë raportuar raste të MERS duke u përfshirë kryesisht në Lindjen e Mesme. MERS mori jetën e 858 njerëzve ndërsa janë infektuar 2,494.⁵³

⁵¹ Wikipedia, (Dhjetor 2019), SARS, Gjetur në: <https://en.wikipedia.org/wiki/SARS>

⁵² Wikipedia, (2009), H1N1, Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/Influenza_A_virus_subtype_H1N1

⁵³ Wikipedia, (Qershor 2012), MERS, Gjetur në: <https://en.wikipedia.org/wiki/MERS>

- **Ebola në Afrikën Perendimore në 2014**

Ebola u shfaq në Guinea, në fillim të vitit 2014, pastaj u përhap shpejt në vendet fqinje. Ebola mori jetën e 11,310 njerëve ndërsa janë infektuar 28,616.⁵⁴

- **Ebola në Republikën Domenikane të Kongos në 2018**

Ringjallja e Ebola në 2018, këtë herë në Republikën Demokratike të Kongos, paraqiti një problem gjithnjë e më pak sfidues sesa në vitin 2014. Shkalla e shpërthimit ka qenë shumë më e vogël, ku mori jetën e 2,280 njerëve ndërsa janë infektuar afërsisht 3,500.⁵⁵

⁵⁴ Wikipedia, (Dhjetor 2013), African Ebola, Gjetur në:
https://en.wikipedia.org/wiki/Western_African_Ebola_virus_epidemic

⁵⁵ Wikipedia, (Dhjetor 2013), Ebola, Gjetur në:
<https://en.wikipedia.org/wiki/Ebola>

4.3. Mungesë të informacionit, rreth koronavirusit “COVID-19”

Është misterioze dhe shqetësuese për disa arsye. Udhëheqësit duhet t'i shikojnë rreziqet e menjëhershme si kërcënime për qëndrimin e tyre dhe të përgjigjen në përputhje me rrethanat. Kjo logjikë përdoret ndonjëherë për të shpjeguar mungesën e angazhimit, ndaj masave duke mendur se kërcënimi është larg dhe nuk ka nevojë të ngutshme politike. Por rreziku i COVID-19, “Life in Pandemics”, është i qartë dhe i pranishëm në Kosovë dhe mbarë botën. Bashkëpunimi dhe kordinimi global, janë të nevojshëm për të adresuar problemin. Duke pasur parasysh se sa kontribuan në tregtin ndërkombëtare, në ekonominë globale dhe shkallën në të cilën tregtia mbështetet në udhëtimin e mallrave dhe njerëzve, botës ose do t'i duhet të pranojë pasoja të rënda ekonomike globale ose të gjejë mënyra për t'i bërë udhëtimet, të sigurt dhe të mundshme në një afat të afërt. Shtetet, duhet të mësojnë si të bashkëpunojnë më gjerë përballë një pandemie sot, ata do të humbin mundësinë për të krijuar apo bashkëpunuar në rrethana të ngjashme në të ardhmën.⁵⁶ Ndërsa zgjedhja midis formave të diplomacisë shëndetësore nuk është se mund të bësh më shumë njërin mund të nënvlerësojë tjetrën. Investimet në diplomacinë shëndetësore mund të gjenerojnë varësi nga rruga që mund të përhapet edhe në fusha të tjera.

COVID-19, në këtë drejtim, mund të ndryshojë modelet dhe jo nivelet e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Diplomacia, po ndjek trendin e përgjithshëm, të ndihmës për zhvillim drejt bilateralizmit të marrëdhënieve ndërkombëtare, të cilat kanë avantazh krahasues në shqyrtimin e pasojave të këtij ndryshimi. Zhvendosja nga diplomacia shëndetësore, në pjesëmarrjen globale, megjithatë ka ngjarë të karakterizohet nga konkurrenca, mungesë të informacionit dhe koordinimit rreth pandemisë. Opsionet e jashtme mund të jenë në rritje për diplomacinë shëndetësore, por ato nuk janë domosdoshmërisht të përshtatshme për sfidat e pandemive.⁵⁷ Nëse shtetet vazhdojnë t'i ushtrojnë këto mundësi të investimit në institucionet shëndetësore globale, kohëzgjatja e pandemisë aktuale dhe e pandemive të

⁵⁶ Wikipedia (2020). 2020 coronavirus pandemic in Kosovo. Retrieved April 22, 2020. url.:

https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

⁵⁷ ILO (31 Mars 2020), Udhezues për punedhësit në lidhje me menaxhimin e vendit të punës gjatë Covid -19, Gjetur në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---ed_dialogue/---act_emp/documents/publication/wcms_749173.pdf

ardhshme, do të të jetë më e gjatë se sa do të ishte, në një botë kundërfaktuale, me diplomaci më të fortë globale pandemike. Diplomatët, kërkojnë ndihmën dhe angazhimin aktiv të shëndetësisë, marrëveshjet që mund të adresojnë sfidat globale të shëndetit. Një numër i madhë i vendeve, janë bërë gjithnjë e më shumë më të angazhuar, në politikat shëndetësore, duke mësuar vlerën dhe integrimin e shëndetit në të gjitha politikat e qeverisë dhe ndryshimet me të të cilat po përballët bota. Nevoja për rritjen e aktiviteteve të politikës së jashtme dhe diplomacinë globale, janë problemet shëndetësore, që kanë krijuar mundësi dhe sfidat për ata që formësojnë politikat e jashtme dhe atë shëndetësore. Andaj duhet të ketë rritje, në përfshirjen dhe koherencën e politikave, në mes të forumeve diplomatike dhe të shëndetit publik, për të përmirësuar ndërlidhjet ndërmjet politikës së jashtme dhe shëndetit global.⁵⁸ Marrëdhënia ndërmjet shëndetësisë, politikës së jashtme dhe tregëtisë, është aktualisht në avantazh të diplomacisë dhe ekspertët e shëndetësisë, kanë një rol kritik në këtë paradigmë të re.

Synimi kryesor i shtetit në pandemi, është mbrojtja fizike dhe ekonomike në shëndetin e qytetarëve të tyre.

Në diplomacinë shëndetësore dhe jo diplomacinë globale të shëndetit, priren të identifikojnë qëllimet e diplomacisë shëndetësore, me qëllimet strategjike të vendeve të përfshira në një diplomaci të tillë. Diplomacia shëndetësore, është si mekanizëm për të menaxhuar rreziqet shëndetësore, që derdhen brenda dhe jashtë çdo vendi, në shëndetin global. Sigurimi i shëndetit global dhe shërbimit të interesit kombëtar, nuk duhet të jenë në tension, argumenti i shumë mbrojtësve globalë të shëndetit, theksojnë se shëndeti më i mirë global mund të shihet si një e mirë publike. Negociatat mbi zbutjen e ndryshimit të klimës, në komunikim përmes politikave, shtetet shpesh vënë përfitime afatshkurtra dhe individuale mbi mallrat kolektive afatgjata ndërsa në përgjithësi do të ketë qëllimet humanitare, me synimin për t'i shërbyer shëndetit publik global. Diplomacia dypalëshe shëndetësore është qeverisur nga parimet humanitare si dhe qëllimet ideologjike.

Bota i është kthyer OBSH-së, për të menaxhuar COVID-19, bashkëpunimi dhe koordinimi global, janë të nevojshëm për të adresuar problemin.⁵⁹

⁵⁸ COUNCIL OF EUROPE, (7 Prill 2020), Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Gjetur në: <https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>

⁵⁹ Peter Van Aelst, Jay G. Blumler. Political Communication in the Time of Coronavirus. Taylor & Francis, 2021. (fq.173)

Në shumë mënyra, pandemia ka konsoliduar, një proces që tashmë ishte duke u zhvilluar, me shumë takime paraprake që u zhvilluan, ndërsa mund të mos jetë ende e qartë, se si do të zhvillohen samitet e ardhshme, në shumë vende që ende po përjetojnë fuqinë e plotë, të pandemisë. Nuk mund të jemi të sigurt, se do të ketë mundësi të ardhshme për udhëheqësit, se si do të funksionojë diplomacia në botë pas COVID-19.⁶⁰

Me aq shpejtësi, sa është përhapur koronavirusi kohën e fundit, keq informimi viral rreth pandemisë Covid-19, e ka tejkaluar atë shumë, duke arritur edhe më shpejt miliona njerëz në çdo kontinent. Dhjetra foto dhe video të personelit mjekësor, të maskuar dhe njerëzve të shtrirë në spitale, kanë shpërthyer nëpër mediat sociale, së bashku me “kura” të rrezikshme, më shumë teori konspirative, për përhapjen e pandemisë.

Sa do shqetësuese të jetë kjo, modelet e dezinformimit të koronavirusit, mund të përdoren si një rast studimi!

Ndër tre faktorët epidemiologjikë, që përcaktojnë se si përhapet një sëmundjes:

transmetueshmëria, qëndrueshmëria dhe ndërlikohja, duke shpjeguar mënyrat e përhapjes së dezinformatës në internet.

Hapi më i drejtë, që duhet hedhur gjatë përpjekjeve, për ta kuptuar njohjen efektive në frenimin e pandemisë Covid-19, në shëndetin global sigurojnë disa perceptime të ndryshme. Duke pasur parasysh shpërthimet, e deri tanishëm sygjerojnë se mund të ketë një largim të mundshëm, nga diplomacia shëndetësore, bazuar në pjesëmarrje globale. Pikërisht problemet më të vështira, janë shëndetësia globale dhe organizatat ndërqeveritare.

Organizata të tilla, si Organizata Botërore Shëndetësore, do të kufizohet gjithmonë nga pretendimet e sovranitetit të shtetit dhe çështjes përcjellëse organizative. Bota ju drejtua OBSH-së, për të menaxhuar COVID-19, por me një kuptim të paqartë të organizatës në rolin dhe kapacitetin e saj.⁶¹ Duke u fokusuar më së shumti në marrjen e informatave dhe burimeve të tij, për zhvillimin e programit dhe shkëmbimin e informacionit, vepron si një mbleshës qendror i të dhënave dhe informacionit shëndetësor, duke punuar me vendet të ndryshme, për të pasur të dhënat në politika efektive.

⁶⁰ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në:

https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

⁶¹ Ministria e Shëndetësisë (04 Maj 2020), Njoftime rreth koronavirusit, Gjetur në:

<https://msh.rks-gov.net/sq/njoftimi-per-coronavirus/>

Në raste të ngutshme, struktura e organizatave globale të shëndetit, mund të jetë shumë kufizuese, duke i shtyerë shtetet të kthehen në alternativë, për të arritur qëllimet e tyre të dëshiruara.⁶²

Shtetet mund të investojnë në diplomacinë shëndetësore bilaterale ose rajonale në rastet më urgjente për të pasur dy arsye strategjike. Së pari diplomacia shëndetësore, dypalëshe-rajonale si më efektive që përmban sëmundje, se sa diplomacia shëndetësore më e gjerë, globalisht gjithë përfshirëse.⁶³

Ndërsa së dyti, shteti mund të shoh përfitime strategjike afatëgjatë, në përdorimin e diplomacisë shëndetësore dypalëshe-rajonale, që i ndihmon ata të zhvillojnë apo të forcojnë marrëdhënie, që mund t'u shërbejnë interesave të politikës së jashtme në të ardhmen.

Largimi nga diplomacia shëndetësore, në shkallë globale mund të pasqyrojë këndvështrim shëndetësor global, strategji të tilla përball një pandemie globale janë thellësisht jostrategjike, pasi pasojat e pandemisë në Kosovë, nuk mund të zgjidhen apo adresohen në mungesë të bashkëpunimit global.

Përderisa ka rrugë ekzistuese, të ndihmës që mund të përdoren në kontekstin aktual, ato mund të përmirësojnë në sigurinë kombëtare ashtu edhe rezultate shëndetësore.

Diplomacia globale e shëndetit si negociatat për çështjet e shëndetit të popullsisë duke kërkuar veprim kolektiv në mbarë botën, që të adresohet në mënyrë efektive.

Nga këndvështrimi global përpjekjet e diplomacisë, duhet bazuar në atë të ngjashme me parimet e renditjes si bazë të multilateralizmit.

Këto përpjekje, duhet të përqendrohen në institucionet globale si OBSH-ja, objektivi i deklaruar i së cilës është arritja nga të gjithë popujt e nivelit më të lartë, të mundshëm të shëndetit.⁶⁴

Duke marrë parasysh takimin me një virus të panjohur, mungesën e informacionit rreth COVID- 19, në fillim të përhapjes së tij u rendit si një nga vështirësitë më të mëdha të kësaj drejtorie. Kjo, sipas tyre, kishte ndikuar edhe në shtimin e panikut te qytetarët.

⁶² COUNCIL OF EUROPE, (7 Prill 2020), Respektimi i demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut në kuadrin e krizës sanitare të COVID-19, Gjetur në: <https://rm.coe.int/sg-information-document-albanian/16809e2116>

⁶³ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në: https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

⁶⁴ Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Departamenti për Diplomaci ekonomike, Gjetur në: <https://www.mfa-ks.net/al/ministria/534/departamenti-pr-diplomaci-ekonomike/534>

Mirëpo, edhe me shtimin e panikut, vihej re se mungonte vetëdija e thellë në mesin e qytetarëve për mbrojtjen nga virusi. Pandemia shkaktoi një ndërprerje serioze në operacionet statistikore në të gjithë botën.⁶⁵

Në krizën aktuale globale të shëndetit, të dhëna dhe statistika të ndara në kohë dhe të besueshme nevojiten në mënyrë kritike për të kuptuar, menaxhuar dhe zbutur humbjet njerëzore, sociale dhe ekonomike që prekin miliarda njerëz.

Por ndërprerjet në operacionet e rregullta të prodhimit të të dhënave të krijuara nga bllokimet e sëmundjes së koronavirusit (COVID-19), të kombinuara me një rritje të paparë të kërkesës për informacion për të monitoruar përhapjen e virusit dhe për të zbutur ndikimet e tij, kanë krijuar sfida të paprecedentë për të dhënat dhe komunitetin statistikor në nivel global, rajonal dhe global.

Për më tepër, pandemia goditi në momentin kur shumë vende tashmë po përballeshin me kufizime serioze të burimeve dhe po përballeshin me thirrje urgjente nga të gjithë sektorët e shoqërisë për të adresuar boshllëqet serioze në të dhënat e nevojshme për të nisur një dekadë veprimi me politika efektive dhe të synuara për të arritur zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, shumë zyra kombëtare statistikore iu përshtatën shpejt sfidave të reja.⁶⁶

Sfida e parë me të cilën u përballën sistemet kombëtare statistikore në mbarë globin ishte ruajtja e vazhdimësisë operacionale të proceseve të rregullta të prodhimit statistikor dhe afati kohor i shpërndarjes së të dhënave, pasi operacionet kryesore të regjistrimit dhe anketimit duhej të riplanifikoheshin ose pezulloheshin përkohësisht.⁶⁷

Si përgjigje, Zyra Kombëtare të Statistikave iu desh të rregullonin me shpejtësi protokollet e tyre të punës në terren dhe kalimin në telekomunikacion, si dhe të përshtatnin operacionet e tyre, në mënyrë që të kalonin nga ballë për ballë në mbledhjen e të dhënave

⁶⁵ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Tiranë, (Prill 2020). Situata e Pandemisë Covid-19, Gjetur në: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/05/Urdhri-254-per-protokoll-strehezat..pdf>

⁶⁶ Deutsche Welle (10 Janar 2022). Kosovë: Nga një situatë e mirë epidemiologjike drejtë përkeqësimit, Gjetur në: <https://www.dw.com/sq/kosov%C3%AB-nga-nj%C3%AB-situat%C3%AB-e-mir%C3%AB-epidemiologjike-drejt-p%C3%ABrkeq%C3%ABsimit/a-60378359>

⁶⁷ FRIEDRICH-EBERT-STIFTUNG, (Nëntor 2020), BOTA E PUNËS NË KOHË PANDEMIE: KRIZË DHE MUNDËSI, Gjetur në: <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/17757.pdf>

telefonike dhe të bazuara në ueb, dhe të përdornin më shumë të dhënat administrative dhe burimet e reja të informacionit.⁶⁸

⁶⁸ Wikipedia (Prill 2020). coronavirus pandemic in Kosovo. Gjetur në:

https://en.wikipedia.org/wiki/2020_coronavirus_pandemic_in_Kosovo

KAPITULLI III

5.E ardhmja e diplomacisë multilaterale pas pandemisë COVID 19

Duke marrë parasysh, se si është zhvilluar diplomacia shëndetësore, gjatë COVID-19 dhe në të kaluarën globale, krizat shëndetësore kanë disa synime:

- duke prezentuar më tepër marrëdhëniet ndërkombetare, në fushë e diplomacisë shëndetësore,
- duke hulumtuar shëndetin global, në marrëdhëniet ndërkombëtare,
- duke përqendruar rolin e politikës dhe disiplinat e saj,
- duke bërë dallimin midis qëllimeve humanitare, strategjike etj.

Aktualisht na mungon të kuptuarit, e shkaqeve dhe pasojave të përdorimit, të një lloji të diplomacisë. Identifikimi dhe zhvendosja nga diplomacia globale, shumëpalëshe shëndetësore si një prirje potenciale në zhvillim. Arsyet e mundshme për këtë prirje, duke u fokusuar në variabla si rivaliteti ndërkombëtar dhe ai relativ, ku shkalla e vështirësisë e paraqitur nga shpërthime të ndryshme.

Diplomacia multilaterale, është zhvilluar krahas diplomacisë dypalëshe kryesisht përmes kongreseve dhe konferencave.

Diplomacia moderne multilaterale, fillon me bashkëthemelimin e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht të OKB-së, Këshillit të Evropës, OSBE-së dhe Bashkimit Evropian.⁶⁹ Në vazhden e sfidave aktuale diplomacia shumëpalëshe është një formë e domosdoshme e diplomacisë ndërkombëtare.

Sfidat globale, me të cilat po përballemi, si ndryshimi i klimës, zhvillimi i qëndrueshëm pas pandemisë, mundësitë dhe rreziqet e teknologjive të reja.⁷⁰

Qëllimi i diplomacisë, si kapjen e shumë nivelesh dhe shumë aktorësh, proceset e negociatave që formojnë dhe menaxhojnë mjedisin e politikave globale për shëndetin.

⁶⁹ Wikipedia, (Mars 2020), Pandemia Covid 19, Gjetur në: https://sq.wikipedia.org/wiki/Pandemia_e_COVID-19

⁷⁰ Sara E. Davies, Adam Kamradt-Scott, and Simon Rushton. Disease Diplomacy. *International Norms and Global Health Security*. John Hopkins University Press. USA. 2015.(fq.16)

Diplomacia kosovare është e dallueshme nga shëndetësia, qeverisja sepse synimet e shteteve në angazhimin e diplomacisë shëndetësore, mund të mos jenë të drejtuara drejt menaxhimit të mjedisit të politikave globale për shëndetin. Përcaktimi i diplomacisë, për sa i përket qëllimeve të saj, reflektohet në një farë mase edhe në llojin e diplomacisë shëndetësore dhe diplomacinë globale shëndetësore. Diplomacia globale e shëndetit, si negociatat për çështjet e shëndetit të popullësisë, që kërkojnë veprim kolektiv në mbarë botën, për të adresuar në mënyrën efektive.

Nga këndvështrimi global, përpjekjet e diplomacisë shëndetësore, bazohen në diçka të ngjashme me parimet e renditjes.⁷¹ Të gjitha përpjekjet duhet të përqendrohen në institucionet globale, si Organizata Botërore Shëndetësore (OBSh), objektivi i së cilës duhet të jetë arritja nga të gjithë popujt e nivelit më të lartë të shëndetit. Në duhet të fokusohemi në “diplomacinë shëndetësore” dhe jo në “diplomacinë shëndetësore globale”, duke identifikuar synimet e diplomacisë shëndetësore, me synimet strategjike të vendeve të tjera, të angazhuara në një diplomaci të tillë. Synimet e sigurimit të shëndetit global dhe të shërbimit të interesit kombëtar, nuk duhet të jenë të përfshira me tensione. Shëndeti më i mirë global, mund të shihet si një e mirë publike. Ekspertët e diplomacisë shëndetësore, kanë bërë thirrje për integrimin e teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare.

Dallimet midis diplomacisë, nga njëra anë dhe politika e jashtme është shumë e rëndësishme nga ana tjetër.⁷² Në të njejtën kohë, gjithashtu ndihmon për të siguruar një pasqyrë të temave, objektivave dhe metodave më të gjera të diplomacisë kosovare në përgjithësi.⁷³

Kosova si shtet i vogël, është pjesë përbërëse e rendit ndërkombëtar dhe vepron në të njëjtin mjedis të gjërë politik dhe ekonomik, si të gjitha shtet e tjera. Kosova në politikën e saj të jashtme, ndjek të njejtat objektiva të sigurisë, prosperitetit dhe mirëqenies së

⁷¹ GAP INSTITUTE. (2020), Impact of COVID-19 pandemic on local government, Gjetur në: https://www.institutigap.org/documents/23503_Ndikimi%20i%20pandemis%C3%AB%20COVID19%20n%C3%AB%20pushtetin%20lokal.pdf?fbclid=IwAR1dmr4MX0cKS0q0bVJPhZ41oxi29w2IOejhrhMzUNjJ0iXYdtn5N_iqF30

⁷² Konrad Adenauer Stiftung - Oda Ekonomike e Kosovës (Dhjetor 2020), Ndikimi I Covid-19, në transformimin digjital, Gjetur në: <https://www.kas.de/documents/286052/0/Policy+Brief+20-12-11+The+Impact+of+COVID-19++on+Digital+Transformation+%28ALB%29.pdf/a483bea7-5842-2228-df54-02b7f1cd58eb?version=1.0&t=1609943350354>

⁷³ Rinvest Instituti (04 gusht 2020), Bashkjetesa me Covid-19, tri shtylla të rimekembjes, Gjetur në: https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2020/August/04/Bashkjetesa_me_COVID_-19_Tri_shtyllat_e_rimekembjes1596539010.pdf

qytetarëve të saj.⁷⁴ Diplomacia e shteteve të vogla, karshi shteteve të mëdha, përdorë të njejtën kuti diplomatike. Ndërsa të gjitha shtetet, ndajnë përkufizimin e plotë të sovranitetit, disa karakteristika ndikojnë në mënyrën se si shtetet e vogla, ndjekin politikat ndërkombëtare. Gama e çështjeve, me të cilat përballen është më e kufizuar, megjithatë ato nuk janë më pak urgjente apo intensive se ato të shteteve të mëdha. Efektet e veprimeve të tyre, në rendin ndërkombëtar gjithashtu prirën të jenë më të fokusuara, në rritjen e angazhimit të tyre dhe përforcimin e zërave të tyre. Struktura dhe proceset, e shumta komplekse të diplomacisë, i tendosin burimet e nevojshme për mbledhjen dhe mbështetjen, për pozicionet e tyre mund të jenë në mungesë në raport me Kosovë. Aktivitetet diplomatike, duhet të mbështeten gjithnjë e më shumë, nga interneti dhe mjetet dixhitale dhe teknologjitë e tjera të informacionit dhe komunikimit (TIK).

Diplomatët kosovarë, mbështeten në internet për të gjetur informacion, për të komunikuar me kolegët përmes emailit dhe për të negociuar, draft tekstet në format elektronik, diplomatët po ashtu përdorin gjithnjë e më shumë platforma të reja, të rrjeteve sociale dhe Facebook, në mundësitë dhe sfidat që ofrojnë mjetet e internetit për aktivitetet diplomatike. Diplomatat gjithashtu shqyrtojnë, implikimet e politikave në këto procese. Inteligjenca artificiale (AI), si çdo teknologji tjetër, nuk vjen pa rreziqe.⁷⁵ Një rrezik, mbi të cilin duhet të fokusohemi, është se Inteligjenca artificiale dhe automatizimi mund të sjellin një formë të re të ndarjes dixhitale, pasi disa pjesë të botës, do të përfitonin nga avantazhet e këtyre teknologjive, ndërsa të tjerat nuk do të kishin akses në to.

Si gjithmonë në histori, ne duhet të pranojmë se duhet të jetojmë me të mirat dhe të këqijat e teknologjisë. Kështu, në diplomaci duhet të fokusohemi, te rreziku dhe të përpiqemi të zvogëlojmë dhe fenojmë ndikimin në menaxhimin e mundshëm, negativ të teknologjive të tilla. Megjithatë, duhet të merren parasysh disa parime të përgjithshme dhe fleksibël që drejtojnë evolucionin e inteligjencës artificiale, në diplomaci dhe vendosin kornizën për zhvillimet e ardhshme.

⁷⁴ Rinvest Instituti (04 gusht 2020), Bashkjetesa me Covid-19, tri shtylla të rimekembjes, Gjetur në: [https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2020/August/04/Bashkejetesa_me_COVID - 19_Tri_shtyllat_e_rimekembjes1596539010.pdf](https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2020/August/04/Bashkejetesa_me_COVID_-_19_Tri_shtyllat_e_rimekembjes1596539010.pdf)

⁷⁵ https://sq.wikipedia.org/wiki/Inteligjenca_artificiale

Për shembull, kohë më parë në mënyrë analoge, me fushën e ndryshimeve klimatike, parimi i parandalimit mund të përdoret për të parandaluar, ndikimin e mundshëm negativ të inteligjencës artificiale, në të drejtat e njeriut dhe shoqërinë.⁷⁶

Pasi negociatat në diplomacinë, janë një fushë e të papriturave dhe sistemin nuk mund të merren me specifikat e identiteteve, pasi ato janë të ndryshme, të papritura dhe arbitrare. Inteligjenca artificiale, mund të ndihmojë diplomatët, për shembull: në përpunimin e të dhënave, por nuk mund të zëvendësojë tërësisht faktorin njerëzor. Inteligjenca artificiale, është e pa kompromis dhe është e verbër ndaj perceptimit, intuitës dhe rrezikut.⁷⁷ Diplomatat njerëzorë mund të zbulojnë të padukshmen, të shohin të padukshmen, të vërejnë të padukshmen dhe kjo nuk është diçka që sistemet e AI mund ta bëjnë, të paktën jo në të ardhmen e parashikueshme. Të tjerë janë të mendimit se negociatat diplomatike, mund të automatizohen, në një farë mase.⁷⁸

Negociatat e automatizuara, mund të funksionojnë mirë në situata fitim apo humbje, por jo domosdoshmërisht në situata komplekse. Nga ana tjetër, edhe pjesët emocionale të negociatave mund të automatizohen. Ekziston gjithashtu një këndvështrim i mesëm: inteligjenca artificiale, do të plotësojë aktivitetet diplomatike dhe ne duhet të shikojmë, se si ta përdorim atë për të përmirësuar funksionet e diplomatëve. E ardhmja e diplomacisë multilaterale, pas pandemisë COVID 19, është zhvilluar më tepër duke përdorur shumë pajisje interneti, mund të përdoren potencialisht si të dyja, një mjet i dobishëm në jetën dhe një armë për sulme kibernetike. Përdorimi i dyfishtë i teknologjisë dixhitale, në diplomaci e bënë më të vështirë rregullimin dhe menaxhimin e negociatave.⁷⁹

